



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:069611
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06788612

Pml.nr.4/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit A. L., për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR. nr. 267/2023 të datës 08.04.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.301/2024 të datës 29.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28 janar 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. L. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR. nr. 267/2023 të datës 08.04.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.301/2024 të datës 29.11.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR. nr. 267/2023 të datës 08.04.2023, të dënuarin A. L., e ka shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 18.03.2023 deri me datë 15.02.2024. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 300 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr.301/2024 të datës 29.11.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar, kurse ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar e ka hudhur si të palejuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Fanol Krasniqi nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.02/2025 e datës 17.01.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit pretendohen se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka bërë ricilësimin e kualifikimit juridik të veprës penale nga vrasja e rëndë në veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm e cila ka rezultuar me shkelje e të drejtës për mbrojtje sepse mbrojtja tërë kohën është dashur të argumentoj lidhur me elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë dhe jo të veprës penale të ricilësuar, për më tepër, gjykata e shkallës së parë nuk ka elaboruar plotësimin e elementeve të veprës penale të ricilësuar, përkatësisht

veprës penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm. Kjo për faktin se në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale nuk ka pasur rrezikim të personave të tjerë, meqë i dëmtuari A. S. nuk ishte fare në shtëpinë e tij, kurse fëmijët e tij nuk kanë qenë të rrezikuar pasi që menjëherë pas shkaktimit të zjarrit janë larguar nga shtëpia e tyre.

Pretendohet se kontradiktë tjetër e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është fakti se në dispozitiv të aktgjykimit konstatohet se të dëmtuarit ishin anëtarët e tjerë të familjes dhe atë bashkëshortja e të dëmtuarit A. S. – V. M. S. dhe fëmijët e tij të cilët kanë qenë në shtëpi e që nga ky përshkrim nuk mund të konstatohet se kush është i dëmtuar në këtë rast edhe pse janë bërë dëme në veturë dhe garazhë që është e kuptueshme që të dëmtuar të jenë pronarët e tyre, mirëpo në të njëjtën kohë të dëmtuar nuk janë konsideruar fëmijët e tyre në rast se vepra penale qenka drejtuar drejt rrezikimit të jetës së tyre e që kjo është në kundërshtim me frymën e ligjit. Për më tepër, theksohet fakti se në rastin konkret del se nuk është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 113 par.32 të KPRK-së duke marrë parasysh se me këtë rast është shkaktuar dëm vetëm në pjesën e përparme të automjetit dhe derën e garazhës dhe i cili dëm nuk e arrin shumën e kërkuar prej 15.000 €. E gjithashtu me këtë rast nuk është rrezikuar as jeta e fëmijëve që gjendeshin në shtëpi, atëherë del se në mënyrë të kundërligjshme është bërë interpretimi i dispozitës ligjore që i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se duke u bazuar në shkresat e lëndës kundër tani të dënuarit ishte ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni

173 par.1 nënpar.1.5 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, mirëpo gjykata e shkallës së parë sipas detyrës zyrtare kishte bërë rikualifikimin e veprës penale, me ç'rast në veprimet e të dënuarit kishte konstatuar se janë realizuar elementet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së. Gjithsesi gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në administrimin e provave kishte bërë rikualifikimin e veprës penale dhe i cili është në harmoni të plotë me dispozitat e KPP-së pasi që vepra e kualifikuar ka përcaktuar dënim më të butë. Përveç kësaj si rezultat i ndryshimit të kualifikimit ligjor dhe provave të administruara natyrshëm është ndryshuar edhe përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i cili gjithashtu është në harmoni të plotë me provat e administruara. Andaj, me këtë rast pretendimet për shkeljet e theksuara janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyetim për secilën pikë të aktgjykimit dhe po ashtu edhe përkitazi me rikualifikimin e veprimeve të të dënuarit e të cilat janë në favor të tij.

Gjykata e shkallës së parë del se në mënyrë të hollësishme ka arsyetuar faktin e rikualifikimit të veprës penale dhe gjithashtu ka ndryshuar përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit, me ç'rast ka përfshirë të dhënat e vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe më të drejtë ka pasqyruar faktin se edhe fëmijët që në momentin kritik ishin të rrezikuar përmes veprimeve të të dënuarit e të cilat ishin parandaluar përmes intervenimit të fqinjëve të tyre dhe pastaj zjarrfikësve që kishin pamundësuar përhapjen e zjarrit në shtëpi. Pretendimi se në rastin konkret nuk ishte realizuar dëmi në vlerë prej 15.000 €, siç përcakton dispozita ligjore është pretendim tërësisht i pabazë, kjo për faktin se duke marrë parasysh përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si vlerë e mbrojtur është përcaktuar rrezikimi i jetës së të dëmtarëve – anëtarëve të familjes së të dëmtuarit A. S., bashkëshortes dhe fëmijëve të tij të cilët në momentin e shkaktimit të zjarrit ishin në shtëpi, pra ishin ekspozuar një rreziku konkret dhe real si pasojë e veprimeve të tani të dënuarit dhe se nuk kishte të bënte me dëmin e shkaktuar në automjetin dhe derën e garazhës, siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e saj janë paraqitur pretendime për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr. 4/2025, më 28 janar 2025

*B.profesionale,
Qefsere Berisha*

*Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka*